

AKTI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË TREGËTARE

"MURATAJ" - shpk -

Sot më datën 14.12.1994 (nëndëdhjetë e katër), këtu në Tiranë, para me AVOKATES Dolores Zamoshnja, u paraqitën personalisht subjektet e mëposhtë:

1) FATOS MURATAJ dhe 2) ARTUR MURATAJ, të dy bijtë e Kasemit të Sanijes, lindur dhe banues në Tiranë, në rrugën "Ferit Xhajko", Nr. me sotësi për të kryer veprimet juridike.

NENI 1

Midis subjekteve të mësipërme si ortakë të vetëm themelues, të cilët krijojnë një Shoqëri Tregëtare me Përgjegjësi të Kufizuar e quajtur "Murataj"-shpk.

NENI 2

Shoqëria e ka selinë e saj legale në Qytetin e Tiranës, në rrugën "Ferit Xhajko", Nr.18.

NENI 3

Shoqëria ka për objekt të saj atë që është përcaktuar në nenin të Statutit të saj.

NENI 4

Kohë zgjatja e Shoqërisë është mbi 10 (dhjetë) vjet dhe mund të shpërbëhet në çdo kohë.

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë me ortakët e saj Themelues: Z. Fatos Murataj dhe Z. Artur Murataj, është në shumën 25000 Marka gjermane, i ndarë pësejllin nga 50 %.

Kapitali duhet të derdhet plotësisht në ndonjë nga Bankat, apo të jetë e depozituar pranë një Noteri. Po kështu dhe për kapitalin në natyrë.

NENI 6

Shoqëria do të administrohet nga të dy Ortakët si Administrator dhe si Administratorë i Përgjithshëm i Shoqërisë Tregëtare "MURATAJ"-shpk- është Fatos Murataj.

NENI 7

Të dy ortakët do të kenë pjesëmarrje në fitimin e Shoqërisë në masën e pjesëmarrjes në kapitalin e Shoqërisë. Të dy ortakët mbeten gjithashtu përgjegjës për detyrimet e Shoqërisë në kufijtë e kapitalit të marrë përsipër.

ORTAKËT E SHOQËRISË
"MURATAJ" -shpk -

Tiranë më 14.12.1994.

(Fatos Murataj dhe Artur Murataj)

Fatos

Artur

S T A T U T I

I

SHOQËRIË TREGËTARE

"MURATAJ" - shpk -



FORMIIMI

Neni 1

Formohet Shoqëria Tregëtare "MURATAJ" -shpk me i ortakëve :
1) FATOS MURATAJ dhe 2) ARTUR MURATAJ, të dy me shtetësi dhe kombësi shqiptare, bijtë e "asemit dhe të Sanijes, lindur dhe banues në Tiranë, nën "Ferit Xhajko", Nr.18.

S E L I A

Neni 2

Shoqëria Tregëtare "MURATAJ"-shpk- e ka selinë e saj në Tiranë rrugën "Ferit Xhajko", Nr.18.

Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj fillimisht në Tiranë dhe më pas në ardhmen dhe në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, prandaj dhe mund të hapë dhe vënd qëndrime të tjera të dyta ,operative,fillimisht përfaqësi dhe agjensi në të gjithë vëndin,si dhe në shtete të tjera të afërta miratimin e organeve përkatëse dhe sipas ligjeve të vendit ku ato kane qendrim.

KOMË ZGJATJA

Neni 3

Shoqëria Tregëtare "MURATAJ"-shpk- do të zhvillojë veprimtarinë e saj ekonomike në afat të pa kufizuar e mbi 10 vjet (dhjetë).Ajo mund të shpërbëhet në çdokohë.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 4

Objekti i veprimtarisë ekonomike të Shoqërisë Tregëtare "MURATAJ"-shpk_ është për sa vijon:

1) Në fushën e tregëtisë :

- Tregëtim të artikujve të ndryshëm të konsumit të gjërë, industriale dhe ushqimore,blegtorale dhe bujqësore,paisje dhe makineri të ndryshme e pjesë këmbimi për to,me shumicë e pakicë ,nëpërmjet importit dhe eksportit të saj.

- Tregëtim të mallrave të ndryshme bujqësore dhe blegtorale, industriale dhe ushqimore,ushqim për blegtorinë,me shumicë dhe pakicë ,nëpërmjet importit dhe eksportit të tyre.

- Tregëtim të mjeteve të transportit (automjete,motoçikleta,bicikleta e pjesë këmbimi e materiale konsumi për to,tregëtim të karburantëve,brifikantëve në pika përkatëse,me anekse të nevojshme,me shërbime riparimi,mirëmbajtje e parkimi mjeteve.

- Veprimtari tregëtare në fushën e ushqimit social, bar-bufe, restorante, hotelet dhe aktivitetet turistike.
- Hapje dhe veprimtari në agjensi doganore dhe operacione tregëtare në misionari.
- Kryerja e transaksioneve të ndryshme të importeve dhe eksporteve të rreze objekti i veprimtarisë së Shoqërisë, që hyjnë në Shqipëri, prekin kurrin e saj shtetëror, ose nuk e prekin fare atë.
- Konsulencë tregëtare e marketingu, e shërbime të tjera të ngjashme me tregëtimin të sistemeve informative, programime, këshillime, shërbime në informatikë e të telematikës, formim të personelit në këto fusha, tregëtim e ritransmetim të sinjeleve televizive e të tjera të kësaj natyre.
- Grumbullim, përpunim dhe tregëtim të produkteve bujqësore, blegtorale medicinale e prodhime të pyllit.

2) NË FUSHËN E PRODHIMIT :

- Veprimtari prodhuese të produkteve bujqësore (mbjellja e produkteve ndryshme bujqësore si perime, sarsavate etj. në serra e tregëtimi i tyre produkteve blegtorale (të qumështit dhe nënprodukteve të tij, të mishit nënprodukteve të tij), veprimtari prodhuese industriale për produkte e produkte të prodhimit industrial si ushqimore dhe asaj të lehtë, importim.

3) NË FUSHËN E INDUSTRIËS :

- Veprimtari industriale me materiale të vetit dhe të porositësit.

4) NË FUSHËN E TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT :

- Veprimtari në transporte të të gjitha llojeve (tokësor, detar e ajror, mallrave e udhëtarëve, me transitime në porte e pika kufitare të Shqipërisë).
- Veprimtari për shitjen e biletave të transportit ndërkombëtar, dhe automobilistik.
- Shërbime të ndryshme ndihmëse portuale e aeroportuale për mjete të (avione, anije e automjete) për udhëtarë dhe bagazhe e mallra të tyre.
- Shërbime të ndryshme të telekomunikacioneve, me projekttime, ndërtim shërbime të të gjitha llojeve që lejohen sipas legjislacionit përkomunikacion.

5) NË FUSHËN E NDËRTIMTARISË :

- Veprimtari ndërtimore për objekte civile, industriale, komunale etj. dhe për shtetin, ndërtim rrugë, kanalizime e vepra të tjera urbane.
- Veprimtari konsulencë, projektuese, preventivuese e zbatuese në fushën ndërtimore për llogari të tretëve;
- Prodhim e tregëtim të materialeve të ndryshme që nevojiten për ndërtimin e objekteve ndërtimore, në prodhimin, përpunimin dhe min e materialeve të drurit.

6) NË FUSHËN E MINIERAVE :

- Shfrytëzim industrial të minierave, kavave, naftës, rezervave mine të çdo lloji, sipas licencës që do të sigurohen për këtë qëllim e tregëtim tyre nëpërmjet importit dhe eksportit të tyre.

%

7) NË FUSHËN E OPERACIONEVE FINANCIARE :

- Veprime financiare me kreditime dhe blerje të kushtëzuara, me ndërtimeshme financiare në përgjithësi :

- Organizim të zyrave për këmbimin e valutave të ndryshme.
- Marrje e dhënije kredishë me qfarde kushti dhe për llogari të treti, operacione burse, këmbio në të gjithë tregjet e mundëshme.
- Lokacione, blerje dhe tjetërsime të pasurive të lujtëshme e të përditëshme, impiante industriale dhe terrene të ndryshme të çdo lloji e të



do:

- Konsulencë ekonomike-financiare, tregëtare dhe marketingu për të tjerë si dhe çdo veprimtari tjetër, që veças ose së bashku me ato, të cilat duhet të konsiderohet e përshtatëshme dhe me leverdi për tjetër e zhvillimin ekonomik të Shoqërisë Tregëtare.

NENI 5

Shoqëria Tregëtare mund të ndryshojë emërtimin, formën, objektin dhe veprimtarinë së saj sipas vendimeve që do të marrin ortakët e Shoqërisë.

KAPITALI I SHOQËRISË

NENI 6

Kapitali fillestar i Shoqërisë Tregëtare "MURATAJ"-shpk- është shumën 2500 (dy mijë e pesëqind) marka gjermane.

NENI 7

Kapitali i Shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimit të marrë nga Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë.

Shoqëria mund të svogëlojë kapitalin e saj, sipas vendimit të marrë nga Ortakëve. Pjesët e kapitalit themelor janë lirish të transferuar në rrugë trashëgimie.

ASAMBLEJA

NENI 8

Asambleja e Shoqërisë Tregëtare "MURATAJ"-shpk- përbëhet prej Ortakëve themelues të saj: FATOS MURATAJ dhe ARTUR MURATAJ.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Shoqëria Tregëtare "MURATAJ"-shpk- deklarohet e krijuar në përputhje me nenet e normave që përmban ky Statut, Akti Themelues dhe ato të legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Shoqëria Tregëtare fiton zotësinë për të vepruar me rregjistrim si person juridik në Rregjistrin Tregëtar të Gjykatës së Rrethit të Tiranës, ndërsa e ushtron aktivitetin ekonomik me rregjistrimin si subjekt në Sektorin e Tatimeve të Rrethit të Tiranës.

NENI 10

Shoqëria drejtohet nga një Këshill Administrativ i kryesuar nga Administratori i Përgjithshëm i saj Z. FATOS MURATAJ. Numuri i anëtarëve të Këshillit Administrativ dhe paga e tyre, detyra, funksionet e çdo anëtarësi rrethohet nga Administratori i Përgjithshëm.

NENI 11

Asembleja e Shoqërisë Tregëtare "MURATAJ"-shpk drejtohet nga Administratori i Përgjithshëm i saj, sipas Aktit të Themelimit të Shoqërisë Z. FATOS MURATAJ.

NENI 12

Shoqëria Tregëtare "MURATAJ"-shpk ka valën e saj me përmbajtje "SHOQËRIA TREGËTARE "MURATAJ" -shpk- TIRANË" ka llogari likuiduese në kë e në valutë të huaj në Banka të Shqipërisë.

NENI 13

Administratori i Përgjithshëm i Shoqërisë Tregëtare ka këto detyra të drejta:

- Të zbatojë planin e zhvillimit ekonomik, të investimeve dhe të gjerësive të drektivat ekonomike të Shoqërisë.
- Të respektojë e të organizojë punën e të punësuarve në Shoqëri.
- Të thërrasë mbledhjet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të Shoqërisë.
- Të përcaktojë detyrat e pagat e vertesve.
- Të marrë vendime të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 14

Administratori i Përgjithshëm i Shoqërisë Tregëtare si dhe Administratorë të autorizuar prej tij, janë të veshur me të gjitha fuqitë për detyrat e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të Shoqërisë Tregëtare pa asnjë kufizim apo përjashtim. Në rastet të tilla administratori i emëruar dhe të autorizuar është i detyruar të njoftojë e të japë llogari Administratoresë Përgjithshme të Shoqërisë Tregëtare.

MARDHËNIJET E PUNËS

NENI 15

Mardhënijet e punës në Shoqërinë Tregëtare "MURATAJ"-shpk rregullohen nëpërmjet kontratës së punës. Për çështje që nuk rregullohen me kontratën punë zbatohen dispozita përkatëse të Legjislacionit Shqiptar.

NENI 16

Si, do të punësuarit në Shoqërinë Tregëtare, i përcaktohet në aktin themelues, detyra, paga apo mënyra e shpërblimit.

Shoqëria merr përsipër, për të gjithë të punësuarit, të respektojë të gjitha rregullat në fuqi të punësimit dhe të sigurimeve shoqërore për të punësuarit. Ndërsa të gjithë të punësuarit janë të detyruar të pranojnë Statutin e Shoqërisë.

Kriteret dhe kufijtë e pagave për të gjithë të punësuarit caktohen nga Administratori i Përgjithshëm i Shoqërisë.

Të punësuarit në Shoqëri përgjigjen sipas ligjit dhe kësaj Statuti mos zbatimin e detyrave dhe për dëmet që i shkaktojnë Shoqërisë.

PËRFAQËSIMI I SHOQËRISË

NENI 17

Përfaqësimi i Shoqërisë Tregëtare "MURATAJ" -shpk i përket prokurorit të Shoqërisë: dy ortakëve FATOS MURATAJ dhe ARTUR MURATAJ, si dhe personave të autorizuar prej tyre. Ata kanë të drejtë të përfaqësojnë Shoqërinë.

edhe në organe gjyqësore e gjykime, të caktoshë e të pushojnë Avokatët
çështje në gjykim.

KONTROLLI I PËRGJITHSHËM

NENI 18

Shoqëria organizon kontrollin e brëndëshëm me një ose më shumë
rtë kontabël të autorizuar, të caktuar për tre vjetë, me mu tësi rieg,
apo pushimi nga puna.

Eksperti kontabël kontrollon zbatimin e ligjshmërisë e të Statutit
dhe garanton që llogaritë dhe inventaret vjetore të pasurisë së Shoqërisë
janë hartuar drejt dhe që japin një pasqyrim të saktë të rezultateve
të operacioneve të vitit të kaluar financiar, të gjëndjes financiare
të trashëgimisë së Shoqërisë në fundin e vitit. Ai kontrollon përsh
e kontabilitetit të Shoqërisë me legjislacionin përkatës në fuqi, dhe
përfunduar kontrollin 15 ditë para diskutimit në Asamble. Ai është p
gjegjës para Asamblesë së Ortakëve dhe para të tretëve për pasojat
dëmshme që rjedhin nga fajet e nënvlerësimet e tij në ushtrimin e
ksioneve dhe vlerësimet e dhëna.

BILANCI DHE TË ARDHURAT

NENI 19

Veprimet ekonomike-financiare të Shoqërisë mbyllet në 31 Dhjetor
të çdo viti, përveç rasteve dhe urdhërave të Veçanta që jep Administratori
i Përgjithshëm i saj. Në fund të çdo periudhe ushtrimore, administ
tori i ngarkuar (emëruar), nxjerr bilancin kontabël të Shoqërisë me
tatin ekonomik Humbje-Fitim, inventare e raporte përkatëse, sipas lig
rregullave dhe dokumentacionit bazë të miratuar nga Organe Përkatëse
ke hartuar dhe raporte me shkrim për administrimin.


Bilanci kontabël vjetor i Shoqërisë miratohet nga Ortaku i vetëm
brënda datës 31 Marsit të vitit pasues me miratimin e bilancit kont
vjetor, Shoqëria vendos për krijimin e fondeve të veçanta, si fondin
akumulimit, fondin rezervë etj. Për rezerva financiare caktohen 5% e
timit vjetor, përderisa ky fond të arrijë sa 10% e fondit themelor
Shoqërisë .Pas këtij niveli, kuota, e rezervimit vjetor është e lirë

Të ardhurat neto, pas veçimit të fondeve si më sipër dhe shlyerj
së detyrimeve fiskale i mbesin për përdorim ortakut të Shoqërisë në
puthje me raportin e kuotës së vënë në kapitalin themelor të shoqë

Në rast se kapitali i Shoqërisë, për shkak të humbjeve, të realiz
rezulton më i vogël se gjysma e kapitalit themelor , të dy ortakët, b
katër muajve, nga data e miratimit të llogarive që përcaktojnë këtë
mbi mundësinë e prishjes së parakohëshme të Shoqërisë. Në rast se pr
nuk shpallet, Shoqëria zvogëlon kapitalin e saj me një vlerë më të v
se ajo e humbjeve që kanë mbetur pa mbuluar nga fondet rezervë.

SHËRBËRJA E SHOQËRISË

NENI 20



Shoërbërja e Shoqërisë Tregëtare mund të vijë në çdo kohë dhe përfardo shkaku, si kumbje e kapitalit, forvë madhore, pamundësi veprtime dhe gjithnjë me dëshirën e vendimin e të dy ortakëve.

Në këtë rast ortakët vendosin mbi mënyrën e likuidimit, duke ar një ose më shumë likuidatorë, të cilëve iu përcaktojnë detyrat.

Në rastin e likuidimit të Shoqërisë, emërtimi i saj do të pas nga shënimi : "SHOQËRI NË LIKUJDIM E SIPËR". Mbas bëhet njoftimi mbylljes së likuidimit dhe kryhen formalitetet e likuidimit, Shoqë Tregëtare çrregjistrohet në regjistrin Tregëtar i Gjykatës së Rre të Tiranës.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHMË

NENI 21

Përse nuk është shprehur plotësisht në këtë Statut, i referohet plotësisht nga Asambleja e Shoqërisë, si dhe ligjeve të veçanta të legjislacionit shqiptar. Ndryshimet e plotësimet e këtij Statuti bë në të njëjtën mënyrë e procedurë me të cilin nxirret vetë Statuti siç kërkohen nga Ligji Nr.7667 datë 28.I.1993. Ndryshimet miratohet Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë. Çdo ndryshim nuk prek personalitetin juridik të Shoqërisë Tregëtare.

NENI 22


Ky Statut përpilohet në katër kopje për tju shpërndarë org përkatëse, nën mes të të cilave: Zyrës së Noterisë, Gjykatës së Rre Tiranës, për të bërë regjistrimin përkatës në regjistrin Tregë të Shoqërive e njohëjn si person juridik të Shoqërisë Tregëtare, një kopje Sektorit të Tatimeve e Taksave të Rajonit përkatës ku bëhen regjistrimet e Shoqërisë si subjekt privat dhe një kopje mbetet si së përbërëse e dokumentacionit të formimit të Shoqërisë Tregëtare.

Ky Statut hyn në fuqi ditën e nxjerrjes së tij nga ortakët, th lues të Shoqërisë Tregëtare së bashku me Aktin Themelues.


Statuti firmoset rregullisht nga të dy ortakët themelues të S

ORTAKËT E SHOQËRISË TRE
"MURATAJ" -shpjt-

(Fatos Murataj)



(Artur Murataj)



Tiranë më _____ 1994.

